

MANUAL PERDORIMI



MORE COLORS TO YOUR TELEVISION!!!



Parathenie,

Çdo gjë që ju duhet është këtu. MoreTV-Box-i ofron mundesine per te shijuar kanalet më të mira shqiptare, por jo vetem, me programacion për të gjitha moshat, filma, muzik e dokumentarë të për zgjedhur...

Qendro komod dhe relaksohuni pasi MoreTV-Box ju sjell një gamë të plotë të kanaleve televizive.

MoreTv ju mundëson të shikoni në kanalet më kryesore programin me një orë kohë vonese.

Tashme e gjithë familja juaj mund te argëtohet ne cdo kohe.....

Ky udhëzues do të bëj të sigurtë që ju të merrni maksimumin e MoreTV-Box-it , duke i shtuar ngjyrat TV -s tuaj, kështu që ju mund të filloni duke gëzuar të gjitha të mirat për ju dhe familjen.

Ofron mundesi per zgjedhjen e gjuhes se programit dhe gjuhen e titrave ne kanalet ku ofrohet si sherbim, EPG informacion I plote dhe I perditesuar mbi programacionin e tanishem dhe te ardhshem si dhe nje permbledhje e shkurter per cdo program televiziv si dhe mundesi per kontroll prinderor.

Permbledhje

UDHEZUES SIGURIE.....	1
KAPITULLI I- “Para Montimit”	
Para ndezjes dhe fikjes se pajisjes	2
Specifikimet e pajisjes More TV.....	3
Aksesorët.....	3
Aksesoret përfshirës.....	3
Portat hyrëse të pajisjes:	4
KAPITULLI II- “Butonat dhe funksionet”	
Funksionet e telekomandës	5
KAPITULLI III - “Lidhjet”	
Pozicioni i Box-it.....	6
Lidhja e MoreTV me TV.....	6
Lidhja e MoreTv-s me Internetin:	7
KAPITULLI IV- “Instalimi Fillestar dhe funksionet bazë”	
Mënyra e hyrjes në kanale:.....	8
Sqarimi I Menus-se:.....	9
Pyetje ndihmuese.....	21

UDHEZUES SIGURIE

More TV është një pajisje e prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë, me model Android Version 9.0. Para se te hapni dhe vendosni në punë këtë pajisje ju lutem tregoni vëmendje në disa elementë sigurie.

- Ruani çdo aksesor që gjendet brenda kutisë duke filluar nga paketimi, fisha, pjesë plastike, manualin e përdorimit, si dhe tregoni kujdes me aksesorët duke i mbajtur ato larg nga femijet.
- Shmangni situatat goditjeve ose përplasjeve të pajisjes duke e vendosur në sipërfaqe të sheshta.
- Mbani larg pajisjen nga lagështira, burimi i ngrohjes, pluhuri dhe rrezet e diellit.
- Mos vendosni pajisjen e More TV-se, pranë burimeve elektromagnetike, pasi janë të predispozuar ndaj shkarkesave elektrike.
- Mos vendosni asgjë mbi More TV-në.
- Shkëputeni aparatit nga priza kryesore si edhe hiqeni kabllin
- gjatë motit me vetëtima, stuhi, apo gjatë mospërdorimit për një kohë të gjatë
- Në rast rrufesh, qëndrimit për një periudhë të gjatë larg shtëpise, ne rekomandojmë të hiqni nga priza pajisjen.
- Para pastrimit, hiqni spinën kryesore të aparatit nga priza. Për pastrimin e tij perdorni një leckë të thatë, pa baze alkoli.
- Mos tentoni të riparoni produktin vetë, sepse hapja e aparatit mund t'ju ekspozojë ndaj voltazhit të lartë apo rreziqeve të tjera. Në rast se vëreni probleme kontakti me suportin teknik.
- Cdo ndërhyrje e paautorizuar në aparat e nxjerr atë jashtë garancisë.

KAPITULLI I “Para Montimit”

Para ndezjes dhe fikjes se pajisjes

- Kujdes para ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike duhet të beni fikjen e pajisjes nga butoni i telekomandës, prisni 3 sekonda pastaj mund ta hiqni nga priza.
- Mos e tërhiqi kurrë kordonin nga pajisja pasi kjo mund ti shkaktoj problem pajisjes.
- Mos e mbingarkoni prizën, zgjatuesin apo përshtatësin duke i lidhur me shumë pajisje për të njëjtin burim të energjisë elektrike, ndryshe kjo mund të shkaktojë një mbingarkesë që të çon në shkarkese elektrike ose një zjarr.
- Sigurohuni që energjia elektrike që furnizon pajisjen te jete AC 100~250V~, 50/60Hz në te kundert nje fuqi e dobët mund të shkaktojë një goditje elektrike.
- Nëse dëshironi të mos harxhoni internet gjatë kohës që nuk shihni TV mundë ta lini në faqen home.

KUJDES !!!!

Mos e tërhiqni kabllin kryesor kur pajisja është në punë.

Për ta fikur aparatit, shtypni butonin "Fikje/Ndezje" në telekomandën

Specifikimet e pajises More TV

Specifikime të përgjithshme mbi pajisjen:

- Sistem OTM (Over-The-top)
- Sistem Android 9.0
- Decoder / STB-e
- Dalje HDMI
- Dalje analoge CVBS
- Dalje analoge SD per lidhje Storage, WebCamera, Mikroфона
- 1 porte Lan
- 2 x USB
- Përditësim automatik /manual Softuerik
- Kontrolli Prindëror

Aksesorët

- Telekomanda
- Kablli HDMI
- Kablli Lidhës AV
- Ushqyes i jashtëm 5V- 2A



Portat hyrëse të pajises:



- Dalje HDMI
- Dalje analoge CVBS
- Dalje analoge SD per lidhje Storage, WebCamera, Mikrofonta
- 1 porte Lan
- 2 x USB

Kapitulli II “Butonat dhe Funksonet”

Funksionet e telekomandës :



-  **POWER**: Shtyp për të ndezur/fikur pajisjen.
-  **INFO**: Shtyp për të marrë informacion mbi paketën, abonimin etj.
-  **CatchUP**: Shtyp për të aksesuar opsionin CatchUp TV.
-  **CC**: Shtyp për të shfaqur titrat nëse programi i suporton.
-  **Aa**: Shtyp për të ndërruar gjuhën nëse programi e suporton.
-  **EPG**: Shtyp për të marrë informacion mbi kanal, programin televiziv, etj.
-  **RETURN**: Shtyp për tu kthyer në menunë parapardhëse
-  **MENU**: Shtyp për të zgjedhur opsionin menu për aplikacionet korresponduese në video, muzikë, foto, website.
-  **ChLIST**: Shtyp për të hapur listën e kanaleve.



Navigation: Shtyp për të lëvizur majtas/djathtas/lart/poshtë
Shtyp OK për të konfirmuar zgjedhjen tënde.



Number keypad 0-9: Shtyp për të zgjedhur një nga numrat



MUTE: Shtyp për të bllokuar volumnin.



Backspace: Shtyp për të fshirë

Kapitulli III “Lidhjet”

Pozicioni i Box-it

- Vendoseni MoreTV Box-in në pozicion horizontal.
- Mos vendosni mbi resiver objekte të rënda si TV.
- Mos e instaloni resiver-in në këto ambiente: vende me vibrime, me ekspozim direkt në rrezet e diellit, vende të lagështa, ambiente me temperatura shumë të larta ose shumë të ulëta, si dhe ambiente pa ajrosje.

Lidhja e MoreTV me TV

Për të lidhur box-in MoreTV me televizorin, ekzistojnë 2 metoda:

- Me kabëll HDMI(rekomandohet),
- AV(me tri ngjyra)

A. HDMI

Lidhni kabllin HDMI me terminalin "HDMI" në panelin e pasmë të MoreTv-s dhe skajin tjetër lidheni me input HDMI të televizorit tuaj.

B. AV

Për të gjithë llojet e vjetra të TV mund të përdoret vetëm kabell AV (me tri ngjyra :e kuqe e bardhë dhe e verdhë)



Lidhja e MoreTV-s me Internetin:

Ka 1 menyre për të lidhur MoreTV box-in me internetin:

- Me kabëll LAN
- Lidhni kabllin e internetit nga routeri juaj në portën LAN.në anën e pasme të BOX-it MoreTV

KAPITULLI IV- “Instalimi Fillestar dhe funksionet bazë”

Ky seksion shpjegon disa prej funksioneve bazë të telekomandës dhe box-it të MoreTV-s.

Pasi box-i është i vendosur në rrymë dhe është i lidhur në rregull me Tv-n dhe internetin, dhe pasi jeni log-uar hapet automatikisht aplikacioni I Moretv-se

Ne te djathte te ekranit ju shfaqet Menu e aplikacionet me opsionet si meposhte :



- **Informacion** (emri I llogarse, emri STB, plani TV, afati pageses, mbi parapagimin, network info(ip dhe ethernet mac adrese e STB))
- **Full EPG**
- **Audio/Titra**
- **CatchUpTV** (Top Channel Dhe klan Tv kthen programacionin 48 ore pas)
- **Setting**
- **Preferencat**
- **Reload**

Informacioni-Jep detaje mbi:

1. Llogaria: "Emri I kontrates".
2. Emri I STB: "Emri me te cilin e ka rregjistruar box-in ne sistem".
3. Plani I TV : "Paketa aktuale(Tring/Dga)".
4. Afati I pageses: "Data e mbarimit te abonimit".
5. Parapagimi: "Abonim mujore/3mujore/12 mujore".
6. Network Info: "LAN Eth: IP".

EPG "Elektronik Program Guide":

1. Guida e Programacionit EPG- Informacion I perditesuar I permbajtjes se programeve te tanishme dhe te ardhshme dhe një përmbledhje të shkurtër ose komentim për cdo program.Kjo I mundëson përdoruesit që të levize ,gjej dhe zgjedhe përmbajtjen sipas titullit, kanalit Llojit...

CATCHUP TV -REPLY TV

Catch UP TV është shërbim Reply TV, që kthen kohën e transmetimit mbrapa për kanalet më të kërkuara aktualisht për Klan dhe Top Channel në vazhdim edhe te tjera, duke risjellë sërish në ekran, çdo program të dëshiruar të 48 – oreve në çdo kohë që dëshironi ta ri-përjetoni.

Me MoreTV, mund të “luhet me kohën” fale Catch UP TV, duke ndalur transmetimin të një programi, për ta rifilluar aty ku e ndalët duke mos humbur asgjë nga ajo që ndodh kur munde te mos jemi per pak kohe.

OPSIONI :PREFERENCAT

Nëse shtypim këtë opsion ndërkohe që jemi te një kanal, nëpërmjet Kodit standart “1234” na dërgon në ndërfaqen “Preferencat” në të cilën kemi mundësi:

1. Të ndryshojmë kodin për të hyrë në këtë ndërfaqe.
2. Mund të kalojmë kanalin te Lista Favorite.
3. Mund të bllokojmë një kanal që të mos na hapet te lista.
4. Mund të huazojmë kanalin nga një box, tek një box tjetër
5. Rradhitjen e kanaleve sipas preferencës.
6. Mundësin e hapjes default të kanalit të parë ose të fundit që po shihnim në momentin e ndezjes së STB.

OPSIONI SETTING

- Nëse shtypim këtë opsion ,na jepet mundësinë të kalohet te ndërfaqja e setting, ku mund të zgjedhim:
- Network (per lidhjen me Internetin)
- Device Preferences
- Remote& Accessories

OPSIONI RELOAD

- Nëse shtypim këtë opsion ,na jepet mundësinë të bëhet reload app Moretv dhe ta rihape perseri.

Pyejtje ndihmuese

Per pyetje dhe pergjigje te pergjithshme ju lutemi te lexoni ketë faqe. Në qoftë se pyetjet tuaja nuk mbulohen më poshtë atëherë na kontaktoni :


- Telefononi këtë numër + **355 44 300 001** Në rast se pergjigjet sekretaria telefonike, do të thotë që të gjithë operatorët janë të zënë dhe nese lini mesazhin zanor, patjetër do telefonoheni në momentin e parë.
- Mund te dergoni email ne adresen email: suport@abissnet.al
- Mund te na shkruani ne chat-in online dhe do ju ndihmoje nje nga operatoret.

<u>Nuk ka energji.</u>	-Kontrolloni nese spina e Tv eshte e vendosur ne prize, po ashtu dhe paisja e Moretv. -Shtypni butonin e ndezjes per te ndezur TV.
<u>Nuk ka figure.</u>	-Rilidhni kabellin HDMI ose Kabellin AV me TV. -Kontrolloni nese Tv eshte I ndezur.
<u>Paisja nuk I perqijet Telekomandes.</u>	-Drejtoni telekomanden drejt paisjes se MoreTv. -Reduktoni distancen paisje-telekomande -Zevendesoni baterite e telekomandes.
<u>Nuk ka ze.</u>	-Kontrolloni lidhjen mes TV dhe portes HDMI te paisjes Moretv. -Kontrolloni volumin tek TV dhe tek paisja e MoreTV.
<u>Ne ekran shfaqet mesazhi : No internet Connection.</u>	-Verifikoni lidhjen e paisjes se MoreTv me Internetin. -Verifikoni nese kabulli LAN eshte I vendosur mire tek ruteri dhe paisja e Moretv. -Provoni restart te ruterit te internetit dhe me pas te paisjes se Moretv.
<u>Paisja eshte bllokuar dhe nuk merr asnje komande.</u>	-Fikni paisjen e MoreTv, prisni 10 sekonda dhe ndizeni serisht.
<u>Si të mund veproj kur kanalet ngrijne ndonjëher?</u>	Testo shpejtësinë tuaj të internetit pas Router-it dhe sigurohu që të jetë mbi 1000kbps Në qoftë vazhdoni te keni akoma probleme edhe pasi keni kryer testimin si më lart, ju lutem telefononi sportin teknik.

Eliminimi i Duhur i Këtij Produkti (Mbetje Pajisjesh Elektrike dhe Elektronike)

(Aplikohet në Bashkimin Evropian dhe në shtetet e tjera të Evropës me sistem të ndarë grumbullimi të mbetjeve).



 Kjo shenjë e ngjitur mbi produkt ose udhëzuesit e tij, tregon se në fund të ciklit të jetës, ky produkt nuk duhet të hidhet bashkë me mbetjet shtëpiake. Për të parandaluar dëmtimin e mjedisit dhe të shëndetit të njerëzve nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve, lutemi ndajeni nga llojet e tjera të mbetjeve që të riciklohet në mënyrën e duhur për të promovuar ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve materiale. Përdoruesit shtëpiake duhet të kontaktojnë me pikën e shitjes me pakicë ku e kanë blerë aparatit, ose me autoritetin vendor, për të marrë informacion se si dhe ku mund të transportohet ky produkt për riciklim të padëmshëm për mjediisn. Përdoruesit tregtarë duhet të kontaktojnë me furnitorin dhe të verifikojnë kushtet e kontratës së blerjes. Ky produkt nuk duhet të përzihet me mbetjet e tjera tregtare për eliminim.